



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:224082

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05465095

Ac.nr.116/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevc, kryetari i kolegjit, Halide Reka dhe Naime Ahmeti - anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.D nga Komuna e M..., Rruga “D. V..”, Nr. 69, kundër të paditurit M.D nga Komuna e M...të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina, baza të kontestit mos përmbushje e kontratës, në lartësi prej 8,275.05 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga paditësi, kundër aktgjykimit C.nr.94/2008 të datës 14.10.2020, i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në seancën jo publike të kolegjit, e mbajtur më datën 08.03.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit A.D nga Komuna e M..., Rruga “D. V..”, Nr. 69, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, C.nr.94/2008 i datës 14.10.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.94/2008 të datës 14.10.2020, ka vendosur dhe atë: “ *I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit: A.D nga M.. me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta obligoj të paditurin M.D nga Mitrovica që ta përmbush kontratën e dt. 18.09.2004 në shumën prej 8,275.05 €, me kamat vjetore 3.5% duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive të detyrimit. II. OBLIGOHET paditësi A.D nga M..., që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguaj të paditurit shumën prej 270 € në afat 15 ditor, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit. III*

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa e te paditurit për pagimin e shpenzimeve te procedurës kontestimore përtej pjesës se aprovuar ne piken II te dispozitivit te ketij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ankesën e paditësit ta aprovoj si të bazuar në ligj, duke e prishur aktgjykimin e shkallës së parë si të pa bazuar në ligj dhe duke e kthyer të njëjtin në rishqyrtim dhe rivendosje, ose pas vlerësimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqës dhe vërejtjeve të caktuara sipas ankesës ta miraton vendimin me të cilin kërkesëpadinë e paditësit do ta miraton si të bazuar në ligj, duke e obliguar të paditurin, ta përmbush obligimin e vetë në bazë të kontratës se datës 18.09.2004, në shumë prej 8,275.05 euro, me kamatë ligjore 3.5 %, nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 06.02.2008, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit për kompensimin e të hollave, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.94/2008 të datës 14.10.2020, me të cilin e ka refuzuar të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësi nuk ka arritur para gjykatës ta argumentojë kërkesën e tij, konform nenit 319 të LPK-së, e as që ka propozuar ekspertizë financiare lidhur me këtë çështje juridike civile. Në rastin e vendosjes mbi refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD 1978 pasi që ky ligj ka qenë në fuqi kur është lidhur kontrata, përkatësisht krijimit të raportit konkret juridik) dhe duke vlerësuar provat e ofruar ka ardhur në përfundim se në rastin konkret pala e paditurit i ka respektuar këto obligime duke vepruar me ndershmëri dhe ndërgjegjshmëri pasi që, i njëjti e ka përmbushur kontratën, ky fakte vërtetohet nga regjistrat e lëshuar nga “NTP Kristal Petrol”, të nënshkruar pa vërejtje dhe me pajtim të plotë sipas parimit bona fides nga paditësi dhe i padituri, si palë kontraktuese, ku po që se llogariten të njëjtat, vërtetohet se i padituri e ka përmbushur obligimin

nga kontrata në tërësi, andaj kërkesëpadia e tij është refuzuar e pabazuar, duke vendosur më saktësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e as në shkeljet e pretenduara në ankesë nga ana e palës paditëse.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiës e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka aplikuar drejtë edhe të drejtën materiale në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Poashtu Gjykata e Apelit e pranon në tërësi arsyetimin dhe përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se i paditur i ka respektuar obligimet që ka pasur ndaj paditësit duke e përmbushur në tersi kontratën të cilin fakt e ka vërtetuar nga regjistrat e lëshuar nga “NTP Kristal Petrol”, dhe të nënshkruar pa vërejtje dhe me pajtim të plotë nga paditësi dhe i padituri, si palë kontraktuese, ku po që se llogariten të njëjtat, (duke e përjashtuar pretendim e paditësit në DM-Marka dhe Euro, pasi që kontrata është lidhur me datë 18.09.2004, kurse në Kosovë ka qenë e aplikuar si valutë zyrtare valuta euro dhe atë që nga janari 2002), vërtetohet se i padituri e ka përmbushur obligimin nga kontrata e datës 18.09.2004, në tërësi dhe nuk i kanë mbetur obligime të papaguara siç pretendon paditësit.

Për më tepër i padituri ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD 1978), pasi që ky ligj ka qenë në fuqi kur është lidhur kontrata, përkatësisht krijimit të raportit konkret juridik dhe sipas këtij ligji është parim që kontrata është ligj për palët, andaj duke u mbështetur në këtë parim palët kontraktuese marrin për obligim që ti përmbushin obligimet e tyre kontraktuese ashtu siç figurojnë në kontratë, apo ta ndryshojnë atë me ndonjë kontratë të mëvonshme. Obligimi për përmbushjen e kontratës nga ana e palës së paditur rrjedh

duke u bazuar me nenin 17 të LMD - së, ku parashihet se pjesëmarrësit e marrëdhënieve të detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij, ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen, përcakton se detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve në marrëdhëniet e detyrimit ose në bazë të ligjit. Palët kontraktuese kanë për obligim që duke u bazuar në ndershmërinë dhe ndërgjegjshmërinë, t'i përmbushin obligimet kontraktuale, ndaj njëra tjetrës ashtu që nga regjistrat e lëshuar nga "NTP Kristal Petrol", të nënshkruar pa vërejtje nga paditësi po qe se llogariten të njëjtat, vërtetohet se i padituri e ka përmbushur obligimin nga kontrata në tërësi, ndërsa fakti se secili artikull i mallit në regjistër ka qenë në DM, i përshkruar e jo në Euro, dhe nga kjo paditësi pretendon se i padituri i ka mbetur borxh edhe 8,275.05 euro, lidhur me mos përmbushjen e kontratës së datës 18.09.2004, marrë për bazë kohen e lidhjes së kontratës dhe ditën e paraqitjes së padisë 06.02.2008, që për krejt këtë periudhë kohore mbi tri vite nga dita e lidhjes së kontratës lëndore dhe pranim/dorëzimin e mallit me regjistrin e artikujve të mallit, e duke shtuar siç dihet publikisht se nga janari i vitit 2002, si valutë zyrtare e aplikuar në Kosovë, ka qenë valuta euro, dhe për më tepër çdo liferim të mallit të dorëzuar që nuk është kontestuar nga paditësi se është dorëzuar, e që ka mundur të liferohet në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit sipas pikës 3 të kontratës lëndore. Nga paditësi në rastin lëndorë jo që është bërë ndonjë kundërshtim apo ndonjë vërejtje eventuale në raport me përmbushjen e kontratës lëndore nga i padituri, por gjatë tërë kësaj periudhe kohore mbi tri vite, nga dita e nënshkrimit të kontratës së lartcekur dhe pranimit të mallit me regjistrin e bashkangjitur, nuk është bërë as edhe veprimi më i vogël në drejtim të paditurit lidhur me ndonjë vërejtje eventuale, deri me rastin e paraqitjes së padisë, dhe atë vetëm pse në regjistër të artikujt e mallit të dorëzuar janë përshkruar në DM e jo në Euro, qe ishte si valutë zyrtare në qarkullim, por këto pretendime të paditësit në ankesë ashtu siç janë vlerësuar edhe nga gjykata e shkallës së parë janë në tërësi të pabazuar në ligj dhe të pa argumentuar në prova shkresore, sepse në këtë rast nuk kemi mos përmbushje të kontratës siç pretendon paditësi, pasi që regjistrimi i mallit i përshkruar në regjistër në DM e jo në Euro, është vetëm çështje teknike në regjistër lidhur me mallin e dorëzuar, dhe është pa relevancë për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestuese sepse valutë zyrtare në qarkullim, për dy vite më herët në atë kohë ishte euro, të cilin mall me artikuj të përshkruar në DM, pa asnjë vërejtje për vitet të tëra nga paditësi, siç u vlerësua me lart është pranuar nga i njëjti, dhe pranimin/dorëzimin e mallit nga i padituri edhe është përmbushur në tërësi kontrata lëndore e lidhur në mes të ndërgjyqësve.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime ishin të paqarta dhe nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se palët kanë për detyrë që në përputhje me ligjin ti paraqesin provat që vërtetojnë faktet mbi të cilat i bazojnë pretendimet e tyre, e në rastin konkret pala paditëse me asnjë provë nuk ka mundur të dëshmojë se me të vërtetë nuk është përmbushur kontrata e lidhur me të paditurin, në pjesën që të bëjë me lartësinë e kompensimit më mall siç janë artikujt e regjistruar në regjistrin e bashkangjitur kontratës lëndore, ashtu që të konstatohej se i njëjti ka të drejtë në atë që e kërkon me kërkesëpadi, në mënyrë që të ketë ndikim për të marr një vendim ndryshe prej atij si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me këto arsye, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pa themeltë ankesën e paditësit, duke e vërtetuar aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë dhe duke shprehur bindjen se një vendim i tillë është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.116/21 datë 08.03.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Adnan Konushevci d.v.